



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS  
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. B35 Prot.

Tiranë, më 22 / 05 / 2019

V E N D I M

Nr. 17 datë 22 . 05 . 2019

**“PËR MIRATIMIN E MASËS SË PAGESËS PËR PERSONALITETE E HUAJA DHE  
VENDASE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK TË TIRANËS”**

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 62, VKM Nr. 748, datë 11.06.2009 “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të personelit akademik të institucioneve publike të arsimit të lartë”, i ndryshuar, pika 9, Vendimi Nr.13, datë 17.11.2016 “Për miratimin e rregullores dhe funksionimit të Bordit të Administrimit të Universitetit Politeknik të Tiranës”, bazuar në propozimin e Administratorit të Institucionit dhe me kërkesë të njësisë kryesore të Universitetit Politeknik të Tiranës.

**V E N D O S I:**

1. Të miratojë pagesën për personalitetet e huaja, të ftuar në Universitetin Politeknik, në masën 6000 lek/ora;
2. Të miratojë pagesën për personalitetet vendase, të ftuar në Universitetin Politeknik, në masën 2500 lek/ora;
3. Ngarkohen Administratori i Institucionit si dhe njësit kryesore të Universitetit Politeknik të Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

**Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.**

**BORDI I ADMINISTRIMIT**

**Kryetar**

**Arben DHIMA**

